



SPIRITUALGIFTSTEST.COM

TESTI I DHUNTIVE

FRYMËRORE TË TË RINJVE

Si të bësh këtë test:

Romakëve 12:3 thotë: "Sepse, nëpërmjet hirit që më është dhënë, i them secilit që është mes jush të mos mendojë më lart sesa duhet të mendojë, por të mendojë në mënyrë të përkorë, sipas masës së besimit që Perëndia i ndau secilit."

Për të përfutur rezultatin më të saktë, përgjigju secilës deklaratë të mëposhtme sipas asaj që je, jo sipas asaj që do të doje të ishe apo që mendon se duhej të ishe. Sa të vërteta janë këto deklarata për ty? Çfarë ke përjetuar? Çfarë të thonë të tjerët? Deri në ç'skallë pasqyrojnë këto deklarata prirjet e tua të zakonshme? Secila pyetje është shumë e rëndësishme kështu që përpiku të mos lësh asnjë prej tyre pa përgjigje. Pikavarazhi juaj llogaritet në fund të testit.

Secilës deklaratë përgjigju sipas shkallës së mëposhtme të pikëve nga 0 tek 5:

0 = Kurrë; E pavërtetë

1 = Rrallë; Rrallë herë e vërtetë

2 = Nganjëherë; Zakonisht e vërtetë

3 = Gjysmën e rasteve; Zakonisht e vërtetë

4 = Pjesën më të madhe të kohës; Vazhdimisht e vërtetë

5 = Tërë kohën; Gjithnjë e vërtetë

Fillo:

1. _____ Unë mund të organizoj shokët e lagjes apo të klasës për të realizuar një qëllim apo një detyrë.
2. _____ Unë mund të kuptoj nëse një deklaratë është nga Shkrimi apo jo.
3. _____ Unë kuptoj mirë Ungjillin, dhe lehtësisht mund t'ua komunikoj të tjerëve.

4. _____ Unë besoj se të tërë kanë nevojë për inkurajim në këtë jetë, dhe mua më pëlqen shumë të shërbej në këtë drejtim.
5. _____ Unë kam bindje të madhe që Perëndia është i angazhuar dhe i përfshirë personalisht në jetën time.
6. _____ Unë nuk harxhoj paratë e mia për gjëra që nuk më nevojiten me qëllim që t'i jap më shumë Perëndisë.
7. _____ Unë kam ëndrra të mëdha që ta jetoj jetën time për Perëndinë.
8. _____ Unë ndjej dhembshuri për ata të cilët po përballen me sfida të vështira në jetë.
9. _____ Unë gjithmonë lutem për të tjerë.
10. _____ Unë e kam për kënaqësi të bëj detyra të përditshme të cilat mbështetin shërbesat e ndryshme të kishës.
11. _____ Unë kaloj shumë kohë duke studiuar Biblën me qëllim që të bëjë ndryshim në jetën e dikujt.
12. _____ Unë mund të krijoj dhe të zbatoj lehtësisht një plan për të realizuar diçka.
13. _____ Unë dëgjoj me kujdes asaj që njerëzit thonë dhe japin mësim me qëllim për të dalluar nëse është e vërtetë apo jo.
14. _____ Unë ndjej një barrë të rëndë për ata të cilët janë të humbur e pa Jezusin.
15. _____ Kur shoh dikë të dekurajuar, unë i kujtoj që Perëndia është i madh dhe sa shpesh Ai ka premtuar se do të kujdeset për të.
16. _____ Unë i besoj plotësisht Perëndisë se Ai do t'u përgjigjet lutjeve të mia në përputhje me vullnetin e Tij të përsosur.
17. _____ Mua më pëlqen shumë të jap para të ndihmoj Kishën të shpërndaj Ungjillin.

18. _____ Kam qejf të krijoj synime dhe t'i arrij ato, edhe pse të tjerë i kundërshtojnë.
19. _____ Unë i konsideroj të sëmuret dhe nevojtarët si njerëz që kanë më shumë nevojë për dashurinë dhe ngushëllimin që Jezusi ofron.
20. _____ Unë pëlqej shumë të ndihmoj të tjerë të mësojnë dhe të rriten në besimin e tyre.
21. _____ Unë dal me gëzim vullnetar për të ndihmuar në kishë kur e di që ndihma ime do të plotësojë një nevojë praktike.
22. _____ Kur jap mësim për Biblën njerëz janë angazhuar dhe duan të mësojnë më tepër.
23. _____ Kur jam në një grup, shoh qartë si secili mund të kontribuojë për të arritur së bashku qëllimin.
24. _____ Unë dalloj me lehtësi kur dikush nuk është i sinqertë apo shtiret.
25. _____ Unë gjithmonë kërkoj mundësi për të zhvilluar marrëdhënie me jo të krishterë.
26. _____ Unë ndjej që Perëndia më shtyn të frymëzoj ata që nuk po rriten në besim.
27. _____ Unë e di që Perëndia do të më nxjerrë nga situata edhe nëse vetë nuk shikoj ndonjë zgjidhje të mundshme të problemit tim.
28. _____ Unë gëzohem kur di se kur unë i jap kishës, kështu njerëz do të ndihmohen dhe dëgjojnë për Jezusin.
29. _____ Unë nuk kam frikë që të ndërmarr rreziqe për të çuar përpara mbretërinë e Perëndisë.
30. _____ Unë jam thellësisht i preokupuar për ata të cilët lëngojnë dhe dëshiroj t'i ndihmojmë ata që të dinë të dalin nga kohët e tyre të vështira.
31. _____ Marrëdhëniet janë shumë të rëndësishme për mua. Unë pa dyshim që gjej më shumë kënaqësi kur jam me njerëz të tjerë sesa kur jam vetëm.

32. _____ Unë pëlqej të jem në prapavijë dhe nuk e kam të nevojshme të tërheq vëmendje për shërbimin tim në kishë.
33. _____ Unë gjej kënaqësi duke u shpjeguar gjera njerëzve që të mund të rriten në frymë dhe personalisht.
34. _____ Unë organizoj gjëra me qëllim që jeta ime të ecë përpara me lehtësi.
35. _____ Unë dalloj shpejt nëse ka një ndikim të keq apo të lig në një situatë.
36. _____ Mua më pëlqen shumë të mësoj përmendësh vargjet e Biblës për t'i ndarë më pas me ata të cilët nuk e njohin Jezusin si Shpëtimtar të tyrin.
37. _____ Unë nuk kam frikë të sfidoj dikë po që se e di se kjo do të nxisë rritje si dhe guxim frymëror në jetën e tyre.
38. _____ Unë me guxim ec përpara me besim po që se ndjej që Zoti po më thotë të bëj diçka.
39. _____ Edhe pse unë i jap Zotit një pjesë të madhe e asaj që kam, Ai me bekon me më shumë sesa kam nevojë.
40. _____ Mua më pëlqen shumë të ndihmoj të tjerë të rriten në dhuntitë dhe aftësitë e tyre.
41. _____ Mua më pëlqen shumë t'i ndihmoj njerëzit që të kalojnë përmes vështirësive të jetës e t'u tregoj atyre dhembshurinë që tregoi edhe Jezusi.
42. _____ Unë kujdesem për kishën dhe dua shumë që ajo të rritet e të ndërtohet në dashuri.
43. _____ Për t'i ndihmuar ata që janë në nevojë rreth meje, unë caktoj paraprakisht kohë dhe bëj përpjekje me sa mundem.
44. _____ Unë e urrej kur dikush përdor vargjet e Biblës duke i nxjerrë nga konteksti për qëllimet e veta.

45. _____ Unë kujdesem për hollësitë kur punoj në një projekt.
46. _____ Unë shpesh herë mund ta dalloj nëse dikush është duke u treguar mashtrules apo jo i ndershëm përpara se kjo t’u bëhet e dukshme të tjerëve.
47. _____ Mua më pëlqen shumë të ndaj atë që Krishti ka bërë në jetën time si dhe se si Ai më ka ndryshuar.
48. _____ Të tjerët më kanë thënë se fjalët e mia i kanë nxitur të bëjnë hov e të rriten në besimin e tyre.
49. _____ Edhe kur kohët janë të vështira, unë besoj që Perëndia do të më ngushëllojë e të më sigurojë për nevojat e mia.
50. _____ Kam një dëshirë të madhe që Perëndia të kënaqet me mënyrën se si unë përdor paratë e mia.
51. _____ Njerëzit shpesh presin prej meje për të drejtuar një grup apo projekt në shkollë apo në kishë.
52. _____ Unë kam nam si person që “kujdeset shumë” dhe që ndihmoj të tjerët kur janë në nevojë.
53. _____ Unë dua për të parë çdo person në kishë duke u përmbushur Porosinë e Madhe.
54. _____ Nëse dalloj një nevojë në kishë, unë thjesht e plotësoj atë pa m’u kërkuar.
55. _____ Unë i kushtoj vëmendje fjalëve që njerëzit përdorin për shkak se çdo fjalë është e rëndësishme dhe ka kuptim.
56. _____ Unë di si të menaxhoj kohën time mirë e se si të kryej detyrat e ditës.
57. _____ Unë i shikoj gjërat qartë si ose të mira ose të këqija, si ose të drejta ose të gabuara, si ose të vërteta ose të pavërteta.

58. _____ Unë ndihem se duhet t'u them shokëve te mi për Jezusin, sidomos ata që nuk shkojnë ne kishë.
59. _____ Kur të tjerët përballen me probleme të vështira, unë me bindje të plotë u tregoj atyre për besnikërinë e Perëndisë ndaj popullit të Tij.
60. _____ Unë nuk shqetësohem shpesh se e di që Perëndia është i fortë dhe që Ai do më ndihmojë në çdo problem që kam.
61. _____ Unë kërkoj për mënyra si e si t'i ndihmojë personalisht të varfrit dhe nevojtarët.
62. _____ Unë nuk kam frikë që të ngrihem dhe të marr përgjegjësi në një situatë të vështirë.
63. _____ Unë kërkoj ata që janë të dëbuar prej shoqërisë dhe i ndihmoj të rimëkëmbin jetën e tyre.
64. _____ Ungjilli i Jezus Krishtit është gjëja më e rëndësishme në jetën dhe në shërbesën time.
65. _____ Unë besoj se kryerja e punëve të zakonshme në kishë, ka një rëndësi të përjetshme.
66. _____ Kur studioj Biblën, zbuloj gjithmonë gjëra të reja dhe interesante për Ungjillin.
67. _____ Dhoma ime është gjithmonë e pastër dhe e rregulluar.
68. _____ Të tjerët më kanë thënë se gjykimet e mia për karakterin e njerëzve, kanë dalë të sakta.
69. _____ Pjesa më e madhe e bisedave të mia me jo të krishterët, më nxjerrin tek besimi im në Jezusin.
70. _____ Nëse shoh njerëz që po kalojnë nëpër vështirësi për sa i takon besimit të tyre, unë u flas e i nxis ata që të kujtojnë çfarë Zoti ka bërë e të kthehen në gëzimin që Ai na ofron.

71. _____ Unë i inkurajoj gjithnjë të tjerët t'i besojnë Perëndisë në gjithçka.
72. _____ Kur marr ndonjë para, gjëja e parë që bëj është të kërkoj nga Perëndia sa dhe si Ai dëshiron që unë të jap.
73. _____ Unë përqendrohem më tepër tek tabloja e përgjithshme sesa tek hollësitë e vogla.
74. _____ Të tjerët kanë thënë se unë i kam ngushëlluar dhe u shërbyer atyre në një pikë të ulët të jetës së tyre.
75. _____ Unë nuk kërkoj që të jem në qendër të vëmendjes, por besoj se Perëndia po më përgatit mua t'u shërbej të tjerëve.
76. _____ Unë gjej gëzim në të qenurit një ndihmues dhe asistues i të tjerëve në shërbesat e tyre.
77. _____ Shpesh herë, Fryma e Shenjtë më jep pikërisht fjalët e duhura për të thënë kur unë jam duke dhënë mësim për diçka.

Udhëzime për pikësimin:

Shkruaj pikët e tua (nga 0-5) për secilën pyetje në kutinë që ka numrin e asaj pyetjeje. Mblidhe secilën kolonë dhe shkruaj shumën e pikëve të tua mbi Kodin e Dhuratës përkatëse. Pasi ta kesh bërë këtë, mund të kontrollosh përgjigjet më poshtë për të parë se çfarë dhuntie frymërore përfaqëson çdo Kod Dhuntie. Pika më e lartë për një dhuratë, është 35. Sa më e lartë pika, aq më i fortë je në atë dhunti frymërore, bazuar kjo tek përgjigjet e tua.

Matriksi i pikëzimit

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22
	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33
	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44
	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55
	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66
	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77
Shuma e pikëve											
Kodet e dhuratave	Ad	Da	Un	Nx	Be	Dh	U	Msh	Pa	Sh	Mës

Kodet e Dhuntive:

Ad = Administrimi

Da = Dallimi

Un = Ungjillëzimi

Nx = Nxitja

Be = Besimi

Dh = Dhënia

U = Udhëheqësia

Msh = Mëshira

Pa = Pastor/Bari

Sh = Shërbimi/Shërbenjës

Mës = Mësimi